



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA RAJONALE TIRANË

Nr. 5388/4 prot.

Tiranë, më 11.12.2025

Lënda: Shpallje për subjektin "FLORES" SH.P.K

SUBJEKTIT "FLORES" SHPK ME NIPT M41828501N

Adresë: Lagjia nr.13, Plazh, Golem, Objekt me nr.pasurie 58/86, Durrës

Durrës

Drejtorja Rajonale e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Tiranë Rajoni I, ka kryer inspektim në subjektin "FLORES" sh.p.k me Nipt M41828501N dhe adresë Lagjia nr.13, Plazh, Golem, Objekt me nr.pasurie 58/86, Durrës. Në përfundim të procesit të inspektimit në mbështetje të ligjit nr. 9634, datë 30.10.2006 "Për inspektimin e Punës", i ndryshuar, është ndërmarrë vendimi përfundimtar i inspektimit me Nr.ISHPSHSH-TR-2025-4792- SHKRESORE-5, datë 26.11.2025, ku ndaj subjektit është vendosur masë administrative kryesore "Paralajmërim".

Në zbatim të procedurave që parashikon ligji nr.99, datë 12.09.2024 "Për Inspekimin në Republikën e Shqipërisë", njoftimi i subjektit për këtë vendim përfundimtar nuk është bërë i mundur të kryhet nëpërmjet dorëzimit personal dhe me postë në adresën ku subjekti ushtron aktivitet, adresa e deklaruar në ekstraktin e QKB-së. Objekti postar është kthyer mbrapsht me shënimin "Adresë e pasaktë".

Bazuar në nenin 162 të ligjit nr. 44/2015 Kodi Procedurës Administrative, Drejtoria Rajonale e ISHPSHSH-së Tiranë Rajoni I ka vendosur, njoftimin e subjektit "FLORES" sh.p.k me Nipt M41828501N dhe adresë Lagjia nr.13, Plazh, Golem, Objekt me nr.pasurie 58/86, Durrës, për njohjen me këtë vendim përfundimtar të inspektimit me anë të shpalljes dhe njoftimit duke e afishuar në zyrat e ISHPSHSH-së, në adresën e subjektit ku është ushtruar inspektim, QKB dhe në mjediset e Drejtorisë Qëndrore të ISHPSHSH-së dhe në faqen zyrtare të web.

Në zbatim të pikës 3 të nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 Kodit të Procedurës Administrative njoftimi do të vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Kundër Vendimit Përfundimtar të Inspektimit subjekti "FLORES" sh.p.k, ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi paraqitet pranë Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit të Inspektoratit të Përgjithshëm sipas ligjit nr.99, datë 12.09.2024 "Për Inspekimin në Republikën e Shqipërisë".

Për njohjen me përmbajtjen e plotë të Vendimit Përfundimtar të Inspektimit dhe marrjen e kopjes së tij mund të paraqiteni pranë Drejtorisë Rajonale të ISHPSHSH-së Tiranë Rajoni I, adresë Rr. "Sheh Ahmet Pazari", nr.10, Tiranë.

Ky njoftim shpallet sot më datë 11.12.2025 dhe qëndron i afishuar deri në datë 22.12.2025.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin.

KRYEINSPEKTORI RAJONAL

Ardit Shabanaj

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
PËRGJEGJËS SEKTORI
ARMANDO LOGA**



Konceptoi: B.Doda

A handwritten signature in blue ink, likely belonging to B. Doda, written below the text "Konceptoi: B.Doda".